



P Z A P
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.407/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHEȚ e pabazuar ankesa Anr.407/2025, e datës 06.02.2025, parashtruar nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025.

A r s y e t i m

Me datë 06.02.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV në të cilën thekson se më datë 05.02.2025, kandidati për deputet i subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës z.Lumir Abdixhiku në tubim elektoral me qytetaret në qytetin e Istogut, për qëllime politike ka përdorur gjuhë fyeze dhe denigruese ndaj kundërshtarve politik, duke deklaruar "*O të shkretë o të mjerë LDK, Rugova, Istogu janë një, do të mbësin përherë, ktu ka lindur Rugovizmi, ktu do të mbrohet Rugovizmi...*". Sipas parashtruesit të ankesës, kandidati i LDK-së për deputet në zgjedhjet parlamentare të datës 09.02.2025, z.Lumir Abdixhiku ka shkelur dispozitat e nenit 34 pika 1.11 të LZP-së, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartekura, ka kërkuar që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjacionin në fuqi. Si provë ka bashkangjitur video linkun <https://www.facebook.com/atch/live/?ref=atchpermalink&v=1082504303674485&rpid=N60XtsKEFRdGizF1>

Më datë 07.02.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkësë për përgjigje deri më datë 07.02.2025, deri në ora 19:00.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik LDK ka kundërshtuar pretendimet në ankesë me arsyetimin se nuk kemi të bëjmë me asnjë formë të gjuhës nxitëse, provokuese që dërgon në akt

dhune kundër personave tjerë apo pasurisë e as gjuhë të urrejtjes ndaj të tjerëve e as nxitëse për urrejtje ndaj dikujt apo diçkaje, në asnjë formë apo rrethane. Përmes përgjigjes në ankesë ka kërkuar nga PZAP që të marrë vendim meritor për rastin në fjalë dhe ka kërkuar që ankesa e subjektit LVV, të refuzohet si e pa bazuar.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën, përgjigjen në ankesë, vëren se ankesa është e pa bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, vlerësoi se pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë, përkatësisht, deklarimi i kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës z.Lumir Abdixhiku në tubimin elektoral në Istog, se “*O të shkretë o të mjerë LDK, Rugova, Istogu janë një, do të mbësin përherë, ktu ka lindur Rugovizmi, ktu do të mbrohet Rugovizmi...*”, nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragraft 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet: “*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalojen nga bërra e ndonjërsi si në vijim: përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografji, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*”.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, nga e cila mund të konsiderohet se janë me përbajtje të nxitjes së urrejtjes, dhe se e njëjtë deklaratë sipas Panelit konsiderohet diskurs që mund të përdoret gjatë fushatës zgjedhore, prandaj si të tilla nuk mund të konsiderohet si shkelje të pretenduar nga pala ankuese.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “*vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi nga parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë se përbëjnë shkelje të kodit të mirësjelljes.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, nen 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesë dhe Parashtesa

Anr.407/2025, datë 09.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.